# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457948**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kush është artisti i njohur që mund t'i bashkohet "Big Brother VIP 6"? Njerëzit më njohin shumë serioz, por… |
| ADRESA | `https://piranjat.al/showbiz/kush-eshte-artisti-i-njohur-qe-mund-ti-bashkohet-big-brother-vip-6-njere-i105005` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 14:12:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 14:04:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e80f67bbdacd74a0e21254345cbbad67259a25c92f9bc2e141e7592785491efd` |
| TEKSTI | `56ac5791468f072877f0bb06785d354684827f8bca44d8da2ea51568fefc5ad4` |
| PAMJA | `93ef6b2fc338b4179af39b6f474ace2848b9ebbc1f773c0fe76af81a7deae85c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6e5a263561ee09cee760a7756bce8e740d2476a4488a89ee9d231e72ec9e42d7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `46a7af3000d16e9ffefcbfa0ca0d8af83c85fda72b67353c14db1e839b49f770` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6e5a263561ee09cee760a7756bce8e740d2476a4488a89ee9d231e72ec9e42d7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHOWBIZ

# Kush është artisti i njohur që mund t'i bashkohet "Big Brother VIP 6"? Njerëzit më njohin shumë serioz, por…

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 16:04




Një tjetër emër i njohur i artit shqiptar mund të jetë në listën e personazheve që do të shohim në "Big Brother VIP 6". Bëhet fjalë për kantautorin dhe kompozitorin Algert Sala, i cili ka lënë të hapur mundësinë për një aventurë televizive brenda shtëpisë së famshme.

I ftuar në emisionin "Lancio" në Top Albania Radio, Sala ka folur për karrierën e tij, projektet muzikore dhe mënyrën se si perceptohet nga publiku. Artisti është i njohur për krijimet e tij muzikore, jo vetëm si këngëtar, por edhe si autor tekstesh dhe kompozitor për artistë të tjerë.

Gjatë bisedës, ai u përball edhe me pyetjen nëse do ta pranonte një ftesë për t'iu bashkuar kastit të "Big Brother VIP 6". Përgjigjja e tij nuk ishte një "jo", përkundrazi, Algerti duket se është i hapur ndaj kësaj eksperience.

"Po, pse jo? Zakonisht njerëzit më njohin shumë serioz dhe më të rafinuar në atë që unë bëj, por nuk jam dhe aq", u shpreh ai.

Kjo deklaratë ka mjaftuar për të ngritur pikëpyetje nëse artisti mund të jetë një prej emrave që do të shohim në sezonin e ardhshëm të reality show-t. Megjithatë, deri tani nuk ka një konfirmim zyrtar për pjesëmarrjen e tij.

Nëse do të hynte në shtëpi, Sala do të kishte mundësinë t'i tregonte publikut një version tjetër të vetes, larg imazhit të rezervuar dhe serioz që ka krijuar ndër vite përmes muzikës.

Dhe kur u pyet se si do të sillej në një situatë të tillë, nëse do të ishte nga ata banorë që përfshihen shpejt në debate apo preferon të qëndrojë i qetë, artisti dha një përgjigje që lë të kuptohet se nuk e sheh veten si personazh konfliktual.

"Jo. Ka mënyra të tjera, ha kokoshka dhe dëgjoj pse jo…", tha ai.

Mbetet për t'u parë nëse kjo deklaratë do të mbetet thjesht një përgjigje hipotetike në një intervistë apo Algert Sala do ta shohë vërtet veten brenda shtëpisë së "Big Brother VIP 6".

## Artikuj te sugjeruar


SHOWBIZ 18 Shtator22:59

**Tronditet showbiz-i turk/ Aras Bulut İynemli, Melis Sezen dhe Sefo mes 18 emrave nën hetim për drogë**

Një operacion i bujshëm ka tronditur showbiz-in turk! Emra të njohur të kinemasë, muzikës dhe sportit janë përfshirë...

SHOWBIZ 18 Shtator18:19

**"Më mori në telefon dhe duhej shumë i lumtur", deklaratat e fortë e vëllait të Princeshë Dianës: Pas vdekjes së saj, Mbreti Charles më tronditi me deklaratën**

Vëllai i Princeshë Dianës, Earl Spencer, ka rikthyer në vëmendje një prej episodeve më të debatueshme pas vdekjes së...

SHOWBIZ 18 Shtator17:59

**E mbajtën të fshehtë për nëntë muaj, Marin bëhet sërish baba**

Një lajm i bukur ka ardhur së fundmi nga Marin dhe bashkëshortja e tij, Alba, të cilët janë bërë sërish prind&eum...

SHOWBIZ 18 Shtator15:26

**Momenti i shumëpritur/ Ueda dhe Arlindi zbulojnë gjininë e fëmijës së dytë**

Dashuria që nisi në "Love Island Albania" duket se po shkruan një tjetër kapitull të bukur familjar. Ueda dhe Arlindi, &cce...

SHOWBIZ 18 Shtator15:05

**"A nuk ishte kjo ajo nga e cila vdiq babai?"/ Kim Kardashian në spital, diagnoza ngjall frikë në familje**

Një diagnozë shëndetësore ka rikthyer në familjen Kardashian një prej kujtimeve më të dhimbshme të së kaluar&e...

SHOWBIZ 18 Shtator13:02

**Shuhet në moshën 81-vjeçare aktorja Gülsen Tuncer e "Dashuri e Ndaluar"**

Aktorja dhe artistja e dublimit turke Gülsen Tuncer, e njohur për publikun shqiptar për rolin e "Tante Arsen" në serialin e fa...

SHOWBIZ 18 Shtator11:44

**Miley Cyrus tregon të pathënat nga propozimi surprizë: Tentova të gjeja unazën e fejesës, gati sa nuk shkatërrova gjithçka**

Miley Cyrus ka rrëfyer një moment të pazakontë nga fejesa me muzikantin Maxx Morando, duke zbuluar se para se ai t'i propozonte n&eu...

SHOWBIZ 18 Shtator10:14

**Ndodh në Për'puthen/ Për herë të parë një konkurrent Indian në mesin e personazheve**

Sezoni i ri i "Për'puthen" nis më 21 shtator dhe produksioni ka nisur të zbulojë disa nga personazhet që do të...

SHOWBIZ 18 Shtator09:59

**Lady Gaga e solli në jetë fëmijën e saj nëpërmjet një nëne zëvendësuese**

Lady Gaga dhe Michael Polanski kanë mirëpritur fëmijën e tyre të parë nëpërmjet një nëne...

SHOWBIZ 17 Shtator22:52

**Rihanna "vjedh" vëmendjen në koncertin e Celine Dion**

Koncerti i këngëtarës së mrekullueshme Celine Dion në Paris kishte një fanse jo të zakonshme. Rihanna u shfaq mes publikut n&...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 18 Shtator

**VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...**

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

AKTUALITET 18 Shtator

**Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas...**

Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

BOTA 18 Shtator

**"Nënë, vazhdo normalisht"/ Banda zhvat 1 milion...**

Një mashtrim i mirëorganizuar duke përdorur inteligjencën artificiale, përmes të cilit anëtarët e grupit kriminal klonon...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

**Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës**

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

**video**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**




**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.